

Shtojca 2 – Kontrata tip për pjesëmarrjen e tërthortë të personit juridik

Kontrata e pjesëmarrjes së tërthortë në Sistemin AFISaR (Albanian Financial Instruments Settlement and Registrations) nëpërmjet Bankës së Shqipërisë

Palët:

Banka e Shqipërisë, në cilësinë **Administratorit** të sistemit AFISaR dhe **Operatorit** të llogarisë së pjesëmarrësit të tërthortë në Sistemin AFISaR (më poshtë referuar si **Administratori**), me adresë: sheshi Dëshmorët, nr. 1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermani, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,

dhe

_____, në cilësinë e **Pjesëmarrësit të tërthortë** (më poshtë referuar si **Pjesëmarrësi**), me adresë zyre në _____, me Licencë _____), përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja/zoti me numër pasaporte/kartë identiteti _____.

Duke qenë se:

1. në bazë të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, për Bankën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Banka e Shqipërisë është agjent fiskal i Qeverisë;
2. në bazë të nenit 31 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006n për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agjentit fiskal të Qeverisë, krijon, mban sistemin e regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, si edhe mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit, duke lehtësuar përdorimin e sistemit të regjistrimit; dhe
3. në bazë të nenit 12 të vendimit nr. _____, datë _____2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores për funksionimin e sistemit qendror

të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve (AFISaR)ö (më poshtë referuar si **öRregullorjaö**), subjekti që dëshiron të marrë pjesë në sistemin AFISaR, duhet të lidhë me Administratorin kontratën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR;

bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme.

Neni 1 Objekti

Objekti i kontratës është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Administratorit, të cilat lindin në kuadrin e ofrimit prej tij të shërbimeve të shlyerjes dhe regjistrimit të titujve në sistemin AFISaR, si pronar dhe administrator i vetëm i këtij sistemi dhe në rolin e operatorit të llogarisë së pjesëmarrësit të tërthortë, dhe të pjesëmarrësit të tërthortë në përputhje me kushtet e kësaj kontrate dhe Rregullores.

Neni 2 Baza ligjore

Kontrata hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Neni 3 Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e përdorur në kontratë kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në Rregullore.
2. Çdo kusht ose dispozitë e kontratës, që mund të sjellë paqartësi interpretohet në kontekstin e Rregullores dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin palët lidhin këtë kontratë.
3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, zbatohen dispozitat e Rregullores, dhe në rast se këto të fundit nuk rregullojnë çështje të veçanta, zbatohen aktet ligjore dhe nënljore të fushës të cituara edhe në bazën ligjore të Rregullores.

Neni 4 Dokumentacioni

Kërkesa për aplikim, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores, të dorëzuara nga Pjesëmarrësi, i bashkëlidhen kontratës dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 6

Mjeti dhe format e komunikimit

1. Për dërgimin/marrjen e instruksioneve të pagesës në lidhje me transaksionet me titujt që shlyen dhe regjistrohen në sistemin AFISaR, Pjesëmarrësi përdor si mënyrë komunikimi urdhrat me shkrim.
2. Urdhrat me shkrim ekzekutohen nga Administratori, duke respektuar oraret e sistemit të përcaktuara në Rregullore.

Neni 7

Llogaria e titullit

1. Administratori hap llogarinë e titullit të Pjesëmarrësit në sistemin AFISaR dhe ia njofton Pjesëmarrësit sipas Aneksit 1, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
2. Pjesëmarrësi mund të kërkojë hapjen e më shumë se një llogarie titujsh në të njëjtën monedhë dhe/ose në monedha të ndryshme të përcaktuara nga Administratori.

Neni 8

Agjenti shlyerës

1. Agjenti shlyerës i zgjedhur nga pjesëmarrësi i njoftohet Administratorit sipas Aneksit 2, pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
2. Njoftimi për ndryshimin e agjentit shlyerës mund të dërgohet në çdo kohë nga pjesëmarrësi, duke paraqitur Aneksin 2, por bëhet efektiv ditën e nesërme të punës në sistemin AFISaR.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Palët kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcaktohen në Rregullore, e cila është e detyrueshme për t'ju zbatuar.

Neni 10

Komisionet e pjesëmarrjes

1. Pjesëmarrësi duhet të paguajë komisionet e përcaktuara në Rregullore për llogarinë e tij në sistemin AFISaR, dhe detyrimet e tjera që lindin nga transaksionet e kryera prej tij pa vonesa kohore.
2. Administratori i sistemit dhe njëkohësisht i operatori i llogarisë së pjesëmarrësit mund t'ia njoftojë Pjesëmarrësit kostot e pjesëmarrjes në mënyrë analitike.

Neni 11

Konfidencialiteti

Palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në mënyrë reciproke, duke bërë përpjekjet maksimale për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundur numrin e personave që disponojnë këtë informacion.

Neni 12

Personat e autorizuar

Pjesëmarrësi, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, njofton Administratorin për personat e autorizuar, të cilët kanë të drejtë të firmosin urdhra në emër të tij.

Neni 13

Ndryshimet e kontratës

Kushtet e kontratës ndryshohen me nënshkrimin e të dyja palëve.

Neni 14

Forca madhore

Palët nuk janë përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve kontraktore për shkak të forcës madhore, për të cilën njoftojnë menjëherë njëra ótjetrën.

Neni 15

Njoftimet

1. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim tjetër formal ndërmjet palëve, me përjashtim të komunikimit të përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate, kryhet me postë zyrtare të regjistruar, faks, e-mail ose në rast pamundësie, kryhet me telefon.
2. Në rast se njoftimi, kërkesa ose komunikimi mbërrin tek i adresuari pas orës 16.30, ai konsiderohet i marrë në orën 08.30 të ditës pasardhëse të punës.
3. Palët njoftojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e mundshme të adresave, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga ndryshimi i tyre.
4. Palët njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve të tyre.

Neni 16

Zgjidhja e kontratës

1. Palët mund të zgjidhin kontratën, me mirëkuptim ose në mënyrë të njëanshme, për mospërbushje të detyrimeve të rëndësishme, duke njoftuar me shkrim njëraó tjetrën të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që ato dëshirojnë të zgjidhin kontratën, duke kërkuar plotësimin e detyrimeve financiare të maturuara, të cilat mund të rrjedhin nga kjo kontratë.
2. Për të gjitha rastet e tjera të zgjidhjes së kësaj kontrate që nuk parashikohen në të, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis palëve në zbatim të kësaj kontrate, dhe që nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Tiranës.

Neni 18

E fundit

1. Për pjesëmarrësit rezidentë, kontrata nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban një kopje.
2. Për pjesëmarrësit jorezidentë, kontrata nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale: 2 (dy) në gjuhën shqipe dhe 2 (dy) në gjuhën angleze, dhe secila nga palët mban nga 1 (një) kopje në gjuhën shqipe dhe 1 (një) në gjuhën angleze.
3. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet kontratës në gjuhën shqipe dhe asaj në gjuhën angleze, mbizotëron dhe është e detyrueshme kontrata në gjuhën shqipe.
4. Kontrata, pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë e të pavarur.

Për Bankën e Shqipërisë:

Marian Gjermani

Drejtor i Operacioneve Monetare

Për _____

Aneksi 1. Llogaria e titullit në sistemin AFISaR

1. Llogaria/llogaritë e titullit në ALL:

2. Llogaria/llogaritë e titullit në valutë:

Monedha

Monedha

Monedha

Nënshkrimi nga përfaqësuesi i Bankës së Shqipërisë

Aneksi 2. Agjenti shlyerës

Agjent shlyerës në për transaksione në ALL

është Banka* _____

Llogaria pranë agjentit shlyerës nr. _____

Agjent shlyerës për transaksionet në valutë:

Në monedhën _____

është Banka* _____

Llogaria pranë agjentit shlyerës nr. _____

Nënshkrimi nga përfaqësuesi ligjor i Pjesëmarrësit/Vula

*Llogaritë e mësipërme janë të vërtetuara me vërtetimet bashkëngjitur, të lëshuara nga Agjenti shlyerës.

